

**MENDIMI JO PAJTUES I GJYQTARES VALDETE DAKA në çështjen penale
PML.nr.Kzz.nr.98/2016**

Më 10 maj 2016, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët e EULEX-it në Gjykatën Supreme ne shqyrtuam çështjen penale PML.nr.Kzz.no.98/2016 lidhur me kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë të paraqitur nga Zyra e Avokatisë e avokatëve mbrojtës Sejdiu dhe Qerkini kundër aktvendimit të Gjykatës së Apelit Pn.nr.162/2016, të datës 9 mars 2016. Në këtë mënyrë unë jap mendimin tim jo pajtues nga anëtarët e tjerë të kolegjit lidhur me lejueshmërinë e parashtrimit të kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë kundër aktvendimit të Gjykatës së Apelit me të cilin gjyqtari, Kryetari i Gjykatës Themelore të Mitrovicës ka urdhëruar transferimin e të dënuarit **HT** nga Qendra Klinike Universitare e Kosovës (QKUK) në Prishtinë në Burgun e Sigurisë së Lartë në Podujevë.

Në këtë çështje penale, me aktgjykimin e Gjykatës Themelore të Mitrovicës P.nr.58/2014 të datës 27 maj 2015, i dënuar **HT** u shpall fajtor për krime të luftës dhe u dënua me dënim të përgjithshëm prej shtatë (7) vjet burgim, vendim i cili është në fazën e apelit në pritje të vendimit të Gjykatës së Apelit, lidhur me ankesën e paraqitur kundër këtij aktvendimi.

I dënuari, gjatë qëndrimit të tij në paraburgim në qendrën e paraburgimit në Dubravë, më 23 shtator 2015, me kërkesën e tij dhe me lejen e Gjykatës Themelore të Mitrovicës u shtrua në spital në Klinikën e sëmundjeve infektive në QKUK për shkak të problemeve shëndetësore, ndërsa më 7 dhjetor të vitit 2015 i njëjti është parë duke u larguar nga klinika i pashoqëruar nga policët, dhe më 16 dhjetor 2015 një mjek ndërkombëtar kreu ekzaminim mjekësor të të dënuarve dhe gjeti se ai nuk vuan nga ndonjë sëmundje dhe se ai nuk ka asnjë arsye mjekësore për të vazhduar të qëndroj në spital. Më 18 shkurt 2016, Kryetari i Gjykatës Themelore të Mitrovicës ka urdhëruar transferimin e menjëhershëm të të dënuarit nga QKUK në Burgun e Sigurisë së Lartë në Podujevë, kurse më 9 mars 2016, Gjykata e Apelit e refuzoi ankesën kundër këtij urdhri.

Mbrojtja e të dënuarit, Zyra e Avokatisë Sejdiu dhe Qerkini paraqiti kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë duke pretenduar se janë shkelur dispozitat përkatëse të Kodit të Procedurës Penale dhe Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve penale, pa saktësuar se cilat dispozita janë shkelur.

Prokurori i Shtetit të Kosovës, me anë të parashtresës KMLP.II.ZZZK.II.no.68/2016 të datës 14.4.2016, propozoi që kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë të hedhet poshtë si e palejueshme, sepse dispozitat e KPPK-së kanë përcaktuar rregulla të qarta se kur mund të kundërshtohet një vendim gjyqësor me anë të kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë.

Unë e mbështes mendimin tim në këto fakte:

Neni 432 i KPPK-së në paragrafin 1 parasheh: Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë kundër vendimit gjyqësor të plotfuqishëm ose kundër procedurës gjyqësore e cila i ka paraprirë marrjes së atij vendimi të paraqitet, pasi procedurat të kanë përfunduar në formë të prerë, dhe

paragrafi 4 përcakton se pavarësisht nga dispozitat e paragrafit 1 të këtij Neni, kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë mund të paraqitet gjatë procedurës penale e cila nuk është përfunduar me plotfuqishmëri vetëm kundër vendimeve të plotfuqishme që urdhërojnë apo që vazhdojnë paraburgimin.

Nga kjo dispozitë ligjore rezulton se është e pamundur paraqitja e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë kundër vendimeve të cilat nuk kanë përfunduar si të plotfuqishme ose kundër vendimeve të cilat nuk janë të lidhura me urdhërimin apo vazhdimin e paraburgimit.

Për më tepër, kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë nuk saktëson fare shkeljet e Kodi të Procedurës Penal dhe Ligjit Penal, për shkak se dispozita e nenit 432 par. 1 pika 1.1, 1.2 dhe 1.3 të KPPK vetvetiu, përshkruan bazat mbi të cilat mund të paraqitet një kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë, dhe në rastin konkret kërkesa nuk përmend dispozitat pretenduar se janë shkelur.

Interpretimi i gjyqtarëve që kanë pas mendim kundërshtues se kjo çështje ka të bëjë me të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të individit nuk qëndron aspak, sepse edhe nga Konventa Evropiane për të Drejtat dhe Liritë e Njeriut parashikohet se duhet të ekzistojnë dy shkallë kundër çdo vendim gjyqësor, dhe në rastin konkret nga shkresat e lëndës është vërtetuar se të dënuarit i është dhënë mundësia për tu ankuar kundër vendimit të gjykatës së shkallës së parë, prandaj edhe këto dispozita janë respektuar.

Bazuar në sa më sipër, konsideroj se kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë duhet të hidhet poshtë si e palejueshme sipas dispozitës së nenit 434 par. 2 pikës 2.1 të KPPK-së.

Gjyqtarja
Valdete Daka